



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut

Nënkomisioni për Barazi Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas

PROCESVERBAL

Tiranë, datë 06.07.2020, ora 13:00

Drejtojnë mbledhjen:

Vasilika Hysi – kryetare e Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut

Eglantina Gjermeni – kryetare e Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe

Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 22 qershor 2020 të mbledhjes së përbashkët të Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas.

2. Shqyrtimi i propozimeve të shoqërisë civile lidhur me masat për parandalimin e dhunës seksuale.

3. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Vasilika Hysi, Eglantina Gjermeni,

Të ftuara:

Bardhylka Kospiri – Zëvendësministre e Shëndetësisë

Romina Kuko – Zëvendësministre e Brendshme

Orsiola Kurti – Përfaqësuese e projektit “ROMACTED” të Këshillit të Europës

Iris Luarasi – Përfaqësuese e Linjës së Këshillimit për Gra dhe Vajza

Mirela Arqimandriti – Përfaqësuese e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim

Ines Leskaj – Përfaqësuese e Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri

HAPET MBLEDHJA

Vasilika Hysi – Përshëndetje, të nderuara kolege dhe kolegë të Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe për Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas dhe të Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut!

Sikurse jeni në dijeni, në bazë të kalendarit të miratuar, kjo është një mbledhje e përbashkët e dy nënkomisioneve, e cila në rendin e ditës ka tri çështje: miratimin e procesverbalit të datës 22.6.2020 të mbledhjes së përbashkët të Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas dhe të Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut; së dyti, shqyrtimin e propozimeve të shoqërisë civile lidhur me masat për parandalimin e dhunës seksuale. Sikurse ju jeni në dijeni, u janë adresuar dy letra një sërë drejtuesve të institucioneve, përfshirë edhe dy nënkomisioneve tona. Njëkohësisht, në adresën e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë ka ardhur një letër nga Qendra për Nisma Ligjore e Qytetare, në datën 10.06.2020, që është një kërkesë publike për një reflektim serioz të institucioneve për marrjen e masave urgjente lidhur me situatën e dhunës seksuale. Të tria këto letra adresojnë një sërë rekomandimesh për shumë institucione, njëkohësisht edhe për Kuvendin e Shqipërisë dhe për dy nënkomisionet tona. Për rrjedhojë, do të ndalemi sot në një seancë dëgjimore me përfaqësuesit e institucioneve, të cilat kanë adresuar letrat përkatëse në të dyja nënkomisionet, që aktualisht janë së bashku në këtë mbledhje, njëkohësisht edhe disa rekomandime drejtuar Kryetarit të Kuvendit.

Për dijeni dhe transparencë, Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë e ka ndjekur me vëmendje letrën e dërguar nga Qendra për Nisma Ligjore e Qytetare dhe e ka kaluar për shqyrtim, ma ka kaluar për mua në cilësinë e zëvendëskryetares së Kuvendit. Rrjedhimisht, në mbështetje të rekomandimit të Kryetarit të Kuvendit, unë ua kam përcjellë të gjitha komisioneve të përhershme parlamentare dhe nënkomisioneve, me qëllim që të ndërmarrin të gjithë hapat e tyre në varësi të fushës së përgjegjësisë që kanë komisionet dhe nënkomisionet. Një pjesë e këtyre çështjeve do të adresohen edhe në grupin e deputetëve “Miqtë e fëmijëve” për atë pjesë ku flitet për fëmijët.

Kjo mbledhje do të moderohet nga kolegja jonë, nga kryetarja e Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas, zonja Eglantina Gjermani, të cilën do të doja ta falënderoja shumë, madje jo vetëm Eglantinën, por të gjithë nënkomisionin dhe të gjithë ju, të nderuar kolegë, që, pas kaq shumë mbledhjesh të gjata dhe të shumta që ne kemi pasur këto ditë, gjetët mundësinë dhe angazhimin serioz për të bërë këtë dëgjesë.

Në bazë të njoftimit të bërë nga sekretaria e përbashkët e të dy nënkomisioneve, ftesa u ka shkuar propozuesve, ose atyre që kanë nënshkruar letrën, janë rreth 48 organizata, por u është lënë vetë përfaqësuesve të tyre të zgjedhin se nga kush do të përfaqësohen në këtë mbledhje.

Sakaq, për këtë mbledhje kanë konfirmuar pjesëmarrjen zonja Iris Luarasi nga shoqata “Linja e këshillimit për gra dhe vajza”, zonja Mirela Arqimandriti nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe zonja Ines Leskaj nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas.

Ftesa i ka shkuar edhe Qendrës për Nisma Ligjore e Qytetare, por, për shkak të një angazhimi tjetër paralel, përfaqësuesit e kësaj qendre nuk do të jenë *online*. Gjithashtu, me kërkesë të një grupi shoqatash rome dhe egjiptiane i janë bashkuar sot për të ndjekur këtë mbledhje edhe zonja Orsiola Kurti, e cila përfaqëson projektin “*ROMACTED*” të Këshillit të Europës, si dhe përfaqësuesit e institucioneve që kanë lidhje me të tria shkresat ose adresojnë çështje që janë në fushën e përgjegjësive të tyre.

Pa dashur të zgjatem më shumë, letrat i kemi të gjithë përpara nesh, të cilat janë adresuar dhe do të kemi mundësi edhe t’i dëgjojmë më shumë propozimet që kanë paraqitur përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Pika e tretë e rendit të ditës lidhet me Nënkomisionin për të Drejtat e Njeriut. Kemi një raport të monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, konkretisht të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, bazuar në misionin e monitorimit që ka bërë Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut në disa nga burgjet e Shqipërisë.

Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Eglantina Gjermani.

Eglantina Gjermani – Përshëndetje të gjithëve!

Shumë faleminderit, zonja Hysi, qoftë edhe për angazhimin dhe kontributin tuaj, si dhe për hapjen e mbledhjes!

Të nderuar kolegë,

Faleminderit që jemi të gjithë bashkë (të dyja nënkomisionet) për të trajtuar një çështje shumë të rëndësishme, njëkohësisht falënderoj të ftuarat: zonjat Luarasi, Leskaj dhe Arqimandriti, ndërkohë që na është bashkuar edhe zëvendësministrja e Mbrojtjes Sociale dhe Shëndetësisë, zonja Kospiri, dhe besoj për pak edhe zëvendësministrja e Brendshme, zonja Romina Kuko, të cilat do t’i bashkohen kësaj seance dëgjimore për të dëgjuar kontributin dhe angazhimet që ka marrë shoqëria civile në mënyrë konkrete.

Edhe një herë, faleminderit!

Dua t'ua jap fjalën tani përfaqësuesve të shoqërisë civile për të prezantuar nismën që ka ardhur me shkrim te Kryetari i Kuvendit dhe të gjitha komisionet apo nënkomisionet respektive. Pas prezantimit nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, do të kemi hapësirë për pyetje e komente për të gjithë kolegët deputetë.

Fjala është për ju, zonja Luarasi.

Iris Luarasi – Më dëgjoni?

Eglantina Gjermani – Po, ju dëgjojmë, mund të vazhdoni.

Iris Luarasi – Faleminderit!

Fillimisht do të doja t'ju falënderoja për të gjithë disponueshmërinë dhe për përgjigjen në një kohë shumë të shkurtër të kërkesës sonë që vjen nga 27 organizata të shoqërisë civile, por vjen edhe pas gjithë këtyre rasteve të prezantuara tashmë edhe në medie, edhe pse, në fakt, gjithnjë ndjenja dhe informacioni ka qenë se ka pafund raste të dhunës seksuale që ndodhin në Shqipëri, por nuk raportohen për mijëra arsye, që tashmë i dimë të gjithë, ndaj nuk po e harxhoj kohën tuaj me këtë gjë dhe po kaloj direkt te pjesa që ka lidhje me kërkesat.

Në fakt, ne mendojmë (kur flas për ne, flas për 27 organizatat) që Kodi Penal, veçanërisht në seksionin VI, që ka lidhje me krimet seksuale, është shumë i vjetër. Pse them që është i vjetër? E kam të hapur kodin, por më tepër për të kaluar te disa prej këtyre neneve. Për shembull, kur kalon që te neni i parë, neni 100 i cili ka lidhje me seksionin VI “Krimet seksuale”, thuhet: “marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me të mitur, kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me fëmijë të mitur e të tjerë”. Që nga ky moment shohim se kemi një kod absolutisht të vjetër, sepse në ditët e sotme marrëdhënia quhet seksuale qoftë nëse ndodh ndërmjet çifteve heteroseksuale, qoftë në momentin kur ndodh mes çifteve homoseksuale. Për këtë arsye them se kodi ka nevojë për disa rishikime.

Ndërkohë, ne kemi mësuar që Ministria e Drejtësisë është duke rihartuar të gjithë Kodin e Procedurës Penale. Në fakt, ndryshimet që ne propozojmë janë emergjente, por, nga ana tjetër, e dimë shumë qartë sa kohë e gjatë kërkohet për të bërë ndryshime në një kod penal. Kur u mblodhën organizatat, e diskutuam këtë gjë, por menduam se nuk pret koha për të pritur pjesën e ndryshimeve që do t'i bëhen të gjithë kodit nga grupet e ekspertëve, por të paktën të kërkojmë disa gjëra që janë jashtëzakonisht emergjente. Në fakt, të gjitha rastet që kanë ndodhur dhe vazhdojnë të ndodhin. Pas rastit të Babrrusë, kanë dalë absolutisht histori të tjera, si me Shtëpinë e Jetimëve në Shkodër, rasti i para tri ditëve që u transmetua përsëri në “Top-Channel” me vajzën 8-vjeçare në Memaliaj. Pra, nga ana tjetër, rastet kanë filluar të raportohen në medie, gjë e cila është tejet e mirë dhe për t'u përshëndetur, sepse, pa diskutim, ne e shohim

medien në këtë pjesë si një aleate dhe si një vend ku njerëzit diskutojnë tema të tilla, në mënyrë që njerëzit të ndërgjegjësohen dhe të ndryshojë perceptimi që fajin e ka viktimja, përkundrazi, për ta çuar fajin atje ku duhet, që në këtë rast është dhunuesi.

Kështu që jemi bazuar jashtëzakonisht shumë në dy konventa. Në njëfarë mënyre edhe në pozicionin që unë kam, si zëvendës-presidente e GREVIO-s, që është Komiteti i Ekspertëve i ngritur nga Këshilli i Europës për implementimin e Konventës së Stambollit, që ka të bëjë me luftën kundër dhunës në familje dhe luftën e dhunës ndaj grave. Nga kjo anë, në njëfarë mënyre, dhe kjo eksperiencë personale, falë faktit që kam pasur fatin të monitoroj vende shumë avangardë nga pikëpamja e të drejtave të njeriut dhe veçanërisht të drejtave të grave, si Suedia, Finlanda, Danimarka dhe së fundi Malta, të bën të kuptosh se cilat janë problemet që mund të kesh kur bën një lloj analize në Kodin Penal.

Gjithashtu, kemi një raport shumë të mirë që GREVIO ka bërë për Shqipërinë dhe neve, si organizata të shoqërisë civile, na shërben në njëfarë mënyre si një guidë dhe një *roadmap* për të kuptuar se cilat janë ndryshimet që duhen kërkuar në Shqipëri, për të qenë në të njëjtën linjë me Konventën e Stambollit. Nga ana tjetër, kur dizenuam letrën lexuam me shumë vëmendje edhe Konventën e *Lanzarote*-it në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe rekomandimet që i bëhen Shqipërisë për sa i përket ratifikimit dhe implementimit të kësaj konvente.

Një nga elementet që e gjejmë jashtëzakonisht të rëndësishëm, madje tani në fakt është një nga *highlighted* kur flasim për pjesën e dhunës seksuale, është përkufizimi i elementit të përdhunimit, një gjë që mungon në Kodin Penal, pra nuk kemi ende një përkufizim në vitin 2020 për fjalën “përdhunim”. Ky është një nga elementet e para dhe do të donim që kjo të jetë një gjë e shkruar dhe e sanksionuar se çfarë quhet përdhunim sipas legjislacionit shqiptar në Kodin Penal.

Dua t’ju them paraprakisht, se para se të bënim këtë takim, kur erdhi ftesa juaj ne patëm mundësi të organizonim një takim absolutisht në baza vullnetare me disa gjyqtarë, prokurorë dhe përfaqësues të Shkollës së Magjistraturës, të cilët me shumë dëshirë dhe vullnetarizëm, për hir të së vërtetës (se kanë ndenjur tri orë atë ditë në takim për të bërë edhe një analizë të kërkesave), janë dakord që të jenë pjesë e grupit të punës që do të draftojë, nëse do të marrim dritën jeshile nga ju.

Element tjetër i kërkesës sonë është pikërisht ndryshimi i Kodit Penal për sa i përket kulturës së pëlqimit, sepse nuk kemi ende një dhënie të pëlqimit në Kodin Penal, pra nuk kemi një dispozitë që e kriminalizon sjelljen seksuale, siç përshkruhet në paragrafin 1, shkronjat “b”

dhe “c” të nenit 36 në Konventën e Stambollit, që, nga ana tjetër, është një detyrim për Shqipërinë.

Kultura e *consent*-it ne e dimë që është në disa legjislacione të përparuara në Europë, tashmë edhe Franca me shumë debate, për hir të së vërtetës, e kaloi ligjin që ka lidhje me dhënien e pëlqimit. Në fakt, ky është një nga ndryshimet kryesore që do të donim të bëhej në Kodin Penal, sepse kjo sjell që barrën për të provuar dhunën dhe rezistencën të mos e ketë viktimja, ashtu siç parashikohet në kodin aktual, sepse, kur viktimja nuk është në gjendje ta bëjë këtë gjë, kjo mund të çojë në rastet e shumta që ndodhin që ato nuk e raportojnë përdhunimin ose në momente të tjera nuk fillon të bëhet një procedim për sa i përket rastit kur ajo nuk e ka mundësinë të provojë se ndaj saj është ushtruar dhunë apo rezistencë.

Për hir të së vërtetës, gjatë gjithë kësaj periudhe që po flitet në medie na kanë ardhur pafund histori grash dhe vajzash edhe në rrjetet sociale, qofshin ato personale që kemi marrë, qofshin ato të organizatave që ne drejtojmë, ku shprehet në mënyrë të jashtëzakonshme pikërisht ky lloj shqetësimi: vajza të reja të cilat kanë pasur një raport me partnerin e tyre, një raport sentimental që në një moment të caktuar mund të jetë kthyer në një raport seksual, por në momentin kur ato nuk kanë dashur që raporti seksual të kryhet, edhe pse është përdorur dhunë ndaj tyre, e kanë gjetur veten të pafuqishme për ta argumentuar që, në fakt, ka qenë absolutisht ky një rast ku ato nuk kanë dhënë pëlqimin. Sigurisht, edhe kodi nuk e ndihmon këtë lloj denoncimi.

Një shqetësim tjetër lidhet me veprën penale të përdhunimit, që përfshin të miturit nga moshja 14 vjeç deri 18 vjeç, dhe që në Kodin Penal thuhet se kanë arritur pjekurinë seksuale. Një nga shqetësimet që ka pasur GREVIO në raportin e tij për Shqipërinë ka qenë pikërisht moshja minimale për pëlqimin seksual që nuk duhet të mbështetet në kritere arbitrare, sepse, nga ana tjetër, ne e dimë shumë mirë që puberteti nuk është një tregues për t’u bërë i rritur dhe ndryshon nga njëri fëmijë tek tjetri; mund të ndryshojë absolutisht kriteri biologjik i pubertetit. Në fakt, edhe në Komitetin e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve është kritikuar goxha përdorimi i kriterit biologjik të pubertetit. Kështu që pjesa e parë, që ka lidhje drejtpërsëdrejti me kërkesat tona, ka të bëjë pikërisht me ndryshimin e përkufizimit. Një herë të ketë një përkufizim për përdhunimin dhe pastaj të flitet për bazën e mungesës së pëlqimit të dhënë me vullnet të mirë dhe, sigurisht, barra e provës të mos i kalojë viktimës, kjo do të ishte e para.

Së dyti, sigurisht do të kërkonim pikërisht ndryshimin e përkufizimit që ka lidhje me fëmijët e mitur ndërmjet 14-18 vjeç mbi bazën e mungesës së pëlqimit. Këtu të hiqet pjesa që

ka lidhje me arritjen ose jo të pubertetit dhe t'i kushtohet një vëmendje e jashtëzakonshme diferencës moshore ndërmjet kryesit të aktit dhe viktimës.

Së treti, të kihet në vëmendje kriminalizimi i sjelljes seksuale pa dhënien e pëlqimit, që, siç e thashë pak më parë, është një nga bazat e Konventës së Stambollit (neni 36) dhe miratimi i masave të nevojshme që çdo kundërvajtje e dhunës seksuale ndërmjet bashkëshortëve ose bashkëjetuesve të aplikohet siç parashikohet nga ligji.

Kjo është pjesa e parë e kërkesave tona.

Pjesa e dytë ka lidhje me miratimin e një regjistri kombëtar të autorëve të krimeve seksuale, sepse, në fakt, një nga gjërat që ne bëmë paraprakisht, para se të shkruanim letrën, ishte pjesa që lidhet me *research*-in që, sigurisht, kryhet për shumë vende të Europës dhe në SHBA. Pa diskutim që në një pjesë të mirë të vendeve të Europës ekziston ky regjistër elektronik për autorët e krimeve seksuale, ndërkohë që në Shtetet e Bashkuara ky regjistër është absolutisht publik, madje një nga eksperiencat që jam e sigurt se shumë prej jush duhet ta kenë provuar kur kanë pasur familjarë të tyre në SHBA: ty mund të të ndryshojë edhe qiraja e banesës në varësi të sa kilometrave larg vendbanimit tënd ka një njeri që më përpara ka qenë autor i një krimi të caktuar seksual.

Domethënë, aq shumë publike është e gjitha kjo gjë, sa që ndikon edhe në aspektin e rritjes apo të uljes së çmimit të qirave në një zonë të caktuar në varësi të afërsisë apo të largësisë që ke me një prej këtyre dhunuesve.

Edhe në Shqipëri ka një lloj matjeje. Aktualisht, janë 98 pedofilë dhe këtu vijmë tek elementi tjetër për të cilin në Kodin Penal mungon përsëri një përkufizim; për pedofilin. Çuditërisht nuk kemi një përkufizim për pedofilin, edhe pse, në fakt, nga Organizata Botërore e Shëndetësisë është dhënë një përkufizim absolutisht shumë i mirë, por, nga ana tjetër, ne e dimë shumë mirë që sipas OBSH-së pedofilia konsiderohet si një sëmundje psikike.

Për sa i përket pjesës që lidhet me regjistrin elektronik kombëtar për viktimat e dhunës në familje, po të shikoni, në fakt, ka edhe një vendim të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për shkak të kërkesave nga njerëz të ndryshëm që kanë kryer veprën e dhunës seksuale dhe që nuk duan që emri i tyre të jetë në regjistër. Në fakt, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka konkluduar se përfshirja e të dhënave në një regjistër kombëtar për autorët e krimeve seksuale nuk përbën një cenim të së drejtës për jetë private të dhunuesve, por, sigurisht, ka qëllim parandalues dhe nuk konsiderohet si ndëshkuese apo sanksion penal.

Nisur edhe nga ky vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, ne mendojmë se Shqipërisë i ka ardhur koha që ta ketë një regjistër të tillë.

Nisa pak më parë t'ju thosha se ka 98 autorë të krimeve seksuale që e kanë kryer dënimin e tyre: janë dënuar nga gjykata, e kanë mbaruar dënimin dhe janë tashmë të lirë nëpër Shqipëri. Në qytetin e Tiranës janë rreth 50 prej këtyre autorëve që e kanë kryer dënimin e tyre, ndërkohë që janë vetëm 2 punonjës policie të ngarkuar për vëzhgimin e tyre. Ne e dimë shumë mirë që nga pikëpamja e burimeve njerëzore është pothuajse e pamundur, sikur heronj të jenë ata dy punonjësit e policisë, nuk kanë mundësi të rrinë pas 50 vetave për t'i gjëmuar se çfarë bëjnë ata.

Pastaj, në momentin që regjistri kombëtar realizohet, unë, si prind dhe si qytetare e këtij vendi, e di shumë mirë që personi, i cili po vjen dhe po merr me qira shtëpinë përballë, atje ku jetoj unë, ka qenë një autor i një dhune seksuale, kështu që për këtë arsye, e kam më të thjeshtë të mbroj fëmijët e mi apo edhe të ndërgjegjësoj pjesëtarë të tjerë të komunitetit, që mund të mos kenë dijeni apo që mund të mos kenë edukimin e duhur. E gjithë çështja ka lidhje me pjesën e ndërgjegjësimit, sepse në të gjitha rastet prevalon e drejta e njeriut, që ka viktimën dhe shoqëria, krahasuar me të drejtën e njeriut, që mundet të ketë dhunuesin. Jo vetëm kaq, por kërkesa jonë për krijimin e regjistrit ka lidhje edhe me afatin e ruajtjes së të dhënave, ai të jetë të paktën 30 vjet, sepse duke e bërë këtë afat 30-vjeçar, kjo pa diskutim bën të mundur të mos fshihen shumë shpejt nga rekordet krimet seksuale të dhunuesve.

Element tjetër, që përsëri mungon në Kodin Penal, është që të kryhet vlerësimi i riskut i të dënuarve seksualë, sepse nga ana tjetër ka një aspekt për të kuptuar, se cila mund të jetë mundësia për recidivizmin e këtyre veprave seksuale. Element tjetër është që të realizohet mbikëqyrja e duhur e këtyre autorëve dhe këta autorë nga ana tjetër të çohen në shërbime të specializuara rehabilitimi. Tashmë ne në Shqipëri i kemi dy qendra që janë të certifikuara për punën që bëjnë me dhunuesit dhe dy qendra të tjera që janë në proces certifikimi, njëra prej tyre është qendra që ne drejtojmë në Tiranë, linja e këshillimit për burra dhe djem. Një tjetër është linja për djem dhe burra në Shkodër, dhe dy qendra që po ngrihen dhe do të certifikohen shumë shpejt, një në Elbasan dhe një në Vlorë.

Kështu që ekziston mundësia që, në ato pak vende ku ky shërbim është i ngritur, patjetër të vihet në shfrytëzim. Për shembull, një nga gjërat që ne e vumë re me shumë shqetësim, ishte për shembull rasti i Kavajës. U liruan nga gjykata a apelit të miturit që kryen dhunën seksuale dhe duke parë hapësirën ligjore, arrije të kuptoje që gjykatësi, edhe sikur ta kishte pasur motër atë vajzën, nuk do të jepte dot një dënim më të ashpër sesa ai që dha. Domethënë, hapësira ligjore ekzistonte për këtë gjë dhe për atë ishte dhënë. Por nga ana tjetër, ata djem nuk u dërguan në shërbime rehabilitimi, sepse duhet të kemi parasysh që vërtet ata

ishin dhunuesit, por ishin të mitur, që duhet të ndryshojnë absolutisht mënyrën dhe mentalitetin e tyre të sjelljes shoqërore për të ardhmen, jo vetëm për shoqërinë, por edhe për ata si individë.

E fundit fare ka lidhje me kastrimin kimik të autorëve të krimeve seksuale, kur dhuna kryhet mbi fëmijë të mitur nën moshën 14-vjeç, pra flasim në këtë rast vetëm për rastet e pedofilisë. E di shumë mirë që kjo shumë njerëz i bën ose të buzëqeshin, ose u duket si një nga ato krimet mesjetare, që ne po propozojmë për ata që janë autorë të dhunës seksuale dhe që në rastin në fjalë, gjithmonë po flasim për pedofilinë, kastrimi jo vetëm që është në legjislacionet evropiane më avangardë të Europës, po përmend këtu Britaninë e Madhe, Norvegjinë, Suedinë, Finlandën, Danimarkën, Francën edhe Gjermaninë, po nga ana tjetër, duhet kuptuar që është ose një injeksion, ose nëpërmjet pilulave dhe sigurisht ajo që ka si efekt, është që shuan epshin seksual të këtyre njerëzve, që këtë gjë e kanë sëmundje, siç njihet nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Për këtë arsye, ne mendojmë që kastrimi kimik është një nga format më të civilizuar të trajtimit që përdoret në ditët e sotme, në të gjitha vendet e zhvilluara të Europës që përmenda, është edhe një lloj terapie hormonale, që heq dëshirën seksuale të shkelësit. Unë gjithmonë mendoj se në të tilla situata është shumë mirë që secili nga ne të bëjë një ushtrim të tillë dhe të mendojë që, po sikur kjo gjëja, larg qoftë, t'i ndodhi fëmijës sim, secilit prej nesh. Unë nuk do të mendoj kurrë personalisht, por mendoj që është 100% e sigurt edhe për ju, që në qoftë se kjo gjë i ndodh fëmijës sim, do të kisha menjëherë në mendje se çfarë t'i ndodhte prej kastrimit seksual atij që kishte kryer aktin e dhunës ndaj fëmijës. Kështu që kjo është arsyeja kryesore pse kemi menduar që kastrimi seksual nuk vjen nga Mesjeta, por është një gjë që vjen nga bota civile perëndimore edhe ekziston edhe në disa prej shteteve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Këto janë kërkesat tona, kështu që ne jemi absolutisht të hapur për t'iu përgjigjur çfarëdolloj pyetjeje.

Faleminderit!

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zonja Luarasi, për të gjithë angazhimin, kontributin tuaj edhe të kolegeve të shoqërisë civile për këtë çështje që na prek të gjithëve!

Shumë faleminderit për prezantimin e një pakete mjaft të gjerë me ndërhyrje!

Në fakt, historia botërore tregon që ndryshime të mëdha ligjore apo hapa të mëdha cilësorë në përmirësime ligjore janë bërë kur kanë ndodhur ngjarje të tilla, të cilat ndërëgjegjësojnë më shumë qytetarët, politikbërësit, shoqërinë civile dhe i bëjnë qytetarët më proaktivë. Ajo që më bën përshtypje, është që lista e organizatave që kanë firmosur bashkë ju, është shumë gjerë dhe më lejoni ta lexoj edhe për kolegët, pavarësisht se e kanë të gjithë, por mendoj që larmia e organizatave tregon edhe gatishmërinë dhe angazhimin e tyre. Ato janë:

Linja e këshillimit për gra edhe vajza; Linja për këshillimin për burra dhe djem; Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim; Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, AWEN, Partnerët e Shqipërisë; Aleanca Kundër Diskriminimit, LGDBTI, Gruaja te Gruaja, Shkodër; Zyra për djem dhe burra, Shkodër; Qendra Shqiptare për Gratë me Probleme Sociale, Durrës; Shoqata “Refleksione”; Shoqata “Unë Gruaja”, Pogradec; Strehëza për gra edhe vajza; Qendra psiko-sociale “Vatra”, Vlorë; Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Qendra “Agtitra Vizion”, Peshkopi; Të bashkuar për kauzën LGBTI, Qendra “Jona”, Tiranë; Forumi i gruas , Elbasan; “Në dobi të gruas Shqiptare”; YVCA Albania; “Të ndryshëm dhe të barabartë”; QZHK, “Sot për të ardhmen”; Adrf Albania; “Tjetër vizion”, Elbasan; Streha LGBTI; Shoqata “Ndhmoni jetën”; Plum Organisation.

Edhe një herë faleminderit për prezantimin e detajuar të paketës që ju propozoni!

Në qoftë se zonja Leskaj apo dikush tjetër nga përfaqësuesit e shoqërisë civile ka për të shtuar diçka në lidhje me atë që përmendi zonja Luarasi, ju lutem fjala është për ju, më pas do ta hapim për pyetje dhe komente.

Zonja Leskaj, keni diçka për të shtuar?

Ines Leskaj - (*Shkëputje interneti*) realizuat menjëherë këtë seancë dëgjimore edhe në thirrje të të gjitha kërkesave tona për të pasur një reagim. Kuvendi, si gjithmonë, falë këtij nënkomisoni, falë jush dhe gjithë kolegëve tuaj, na është përgjigjur ndër të parët. Unë besoj se Iri bëri një përmbledhje shumë të mirë dhe nuk dua t’ju marr më shumë kohë.

Ju falënderojmë edhe një herë për angazhimin dhe shpresojmë që të dalim me rekomandime konkrete pas kësaj seance!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Leskaj!

Shikoj që na është bashkuar edhe zonja Kuko, zëvendësministrja e Brendshme. Shikoj edhe zonjën Iva Zajmi, ekspertin, pedagogun nga UNICEF.

Fjala është për ju, të nderuar kolegë, në qoftë se keni pyetje, komente lidhur me çfarë u prezantua, lidhur me materialin që të gjithë e keni në e-mail, propozimet konkrete të bëra 27 organizata të shoqërisë civile, pikërisht për të parandaluar apo trajtuar një problem kaq të mprehtë, abuzimin seksual, dhunën seksuale.

Zonja Hysi, fjala është për ju.

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit Iris, për prezantimin që i bëtë nismës! Ndjesë që unë nuk jam aty bashkë me Eglantinën, por duhet të ruajmë distancimin, dy metra larg nga njëri-tjetri, ky është rregulli dhe për këtë arsye jemi ndarë në dy ambiente të ndryshme.

Unë kam një pyetje lidhur me ndryshimet që ju propozoni në Kodin Penal, duke dashur të vë në dukje se edhe në vitin 2018 CRCA-ja, ka prezantuar disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Ne i kemi shqyrtuar në një mbledhje të Komitetit për Shoqërinë Civile, që është pjesë e grupit të deputetëve Miqtë e Fëmijëve, me prezencën e institucioneve si Avokati i Popullit, Komisionerit, UNICEF-it, Save the Children, përfaqësuesve nga ministrinë, ku bëhet fjalë për krimet seksuale dhe krimet kompjuterike dhe tashmë në përgatitje të këtij takimi i lexoj të dyja propozimet, edhe propozimet që bëni ju në kuadër të GREVIO-s dhe Konventës të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga abuzimi, dhe propozimet që janë bërë në kuadër të Konventës së Kombeve të Bashkuara.

A ka një dakordësi midis të gjitha organizatave propozuese për të pasur një formulim të këtyre ndryshimeve, që të jenë në përputhje me standardet, me të gjitha konventat që ju përmendët dhe për t'u diskutuar më pas me Ministrinë e Drejtësisë?

Zonja Zajmi ka qenë në atë takim dhe ne i kemi diskutuar gjerësisht riformulimet që kanë ardhur në atë kohë, por nuk u pranuan për t'u futur në procedurë parlamentare, për shkak se pati shumë debate në lidhje me standardizimin e tyre në përputhje me konventat dhe ju jeni zëvendës-presidente e GREVIO-s, por këtu kemi edhe përfaqësues me përvojë të gjatë. Pra, pyetja, për ta përmbledhur: a ka një unifikim, sepse ju përmendët që gjyqtarët dhe prokurorët janë të gatshëm të kontribuojnë dhe do të ishin të gatshëm që të merrnin të gjitha nismat dhe kërkesat që janë depozituar në Komisionin e Ligjeve dhe të kemi një riformulim të standardizuar?

E dyta, lidhur me regjistrin. Ju flisni për regjistrin kombëtar të autorëve të krimeve seksuale, herë përdorët fjalën “pedofili”, herë përdorët fjalën “krime seksuale”. Në vlerësimin tim këto nuk janë dy gjëra të njëjta, pedofilët dhe rastet e krimeve seksuale, sepse në Kodin Penal ne kemi dhe krime seksuale në mjedise publike ose të krimeve seksuale me të rritur pa pëlqimin e bashkëshortëve e kështu me radhë, fjalën e keni për regjistrin e pedofilëve apo të të gjithë autorëve të veprave penale që kryejnë krime seksuale ndaj kujtdo apo vetëm ndaj fëmijëve nën moshën 14-vjeç? Dhe shifra 98, që ju përmendët, janë 98 autorë, nuk besoj të jenë 98 pedofilë?

Gjithashtu, lidhur me vlerësimin e riskut të të dënuarve, kjo kërkesë ose ky rekomandim është përmbushur tashmë, pasi Kuvendi ka miratuar paketën e ligjeve të burgjeve dhe në ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve” është futur analiza e riskut, ku një element i veçantë është edhe risku për vetëvrasje, për persona të dhunshëm, për persona që mund të kryejnë krime seksuale. E vetmja gjë që mbetet është që ju,

të gjitha organizatat e shoqërisë civile, të bashkëpunoni me administratën e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, me Shërbimin e Provës, për të adresuar dhe përgatitur protokollet përkatëse.

E fundit fare, për dijeninë e të gjithë kolegëve, Kryeministri, me urdhrin nr .75, të datës 09.06.2020, një ditë pasi ju keni hartuar këtë letër, ka ngritur një grup ndërinstitucional pune për përmirësimin e sistemit të parandalimit dhe adresimit të dhunës ndaj të miturve, grup që e drejton vetë Kryeministri. Në përbërje të tij janë të gjitha institucionet dhe ministratë përkatëse. Ndërkohë, unë dua, edhe për t'ju vënë në dijeni, që në mbledhjet e grupit ndërinstitucional të punës të ftohen të marrin pjesë edhe organizatat e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare, institucionet e arsimit të lartë, Urdhri i Psikologut, Urdhri i Punonjësve Socialë etj. Në këtë kuadër, dua të bëj edhe një pyetje. Sa e vërtetë është që ju i jeni drejtuar KQZ-së, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me një nismë për 20 firma të qytetarëve për hartimin e regjistrit kombëtar të autorëve të krimeve seksuale? Jeni për krijimin e nismës me 20 firma apo jeni për shqyrtimin e këtij propozimi si nismë e këtij grupi ndërinstitucional, ku është edhe Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Brendshme apo me nismë deputeti?

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Zonja Luarasi, fjala është për ju!

Iris Luarasi – Ju falënderoj shumë për pyetjet!

Për pyetjen e parë, që ka lidhje me regjistrin e autorëve të krimeve seksuale, sigurisht që ky regjistër do të përfshijë të gjithë autorët e krimeve seksuale, përfshirë edhe pedofilët. Domethënë, ky është një nga sqarimet dhe faleminderit shumë, zonja Hysi, që e sollët në vëmendje, që pa diskutim ne kërkojmë që regjistri të jetë kombëtar për të gjithë ata që kryejnë vepra të krimeve seksuale, sepse po aq i pambrojtur ndihet jo vetëm një fëmijë i mitur, sigurisht mendja gjithmonë shkon tek të miturit, por po aq e pa- ndrojtur ndihet edhe një vajzë 19-vjeçe, që nuk e ka marrë edukimin seksual në shkollë, që prindërit i ka të paarsimuar dhe që gjendet gjithmonë nën presionin e moshatarëve. Ne patjetër që e dimë shumë mirë sesi funksionon përgjithësisht një krim, që ka lidhje me dhunën seksuale, kështu që kjo kërkesë ka lidhje me të gjithë autorët e krimeve seksuale, përfshirë edhe pjesën e pedofilëve.

Ajo që ne do të kërkonim do të ishte që, në mënyrë absolute, të kishte një regjistër publik për të gjithë autorët e krimeve seksuale, por në qoftë se kjo nuk do të funksiononte, regjistri duhet të kryhet dhe të kryhet të paktën ndërmjet institucioneve ku një autor i krimeve seksuale mos ta ketë më të thjeshtë pasi ka kryer dhunën seksuale në Vlorë, të vijë në Tiranë dhe të bëjë të njëjtën gjë, sepse nuk e di askush që ai ka ikur nga Vlora pasi ka kryer dënimin.

Regjistri Kombëtar i Autorëve të Krimeve Seksuale do të parashikojë që një i dënuar, i cili ka kryer dënimin, pa diskutim do të ishte normale, brenda një periudhe një ose dyjavore, sa herë që ndryshon banesën, sa herë që ndryshon vendin e punës, të lajmëronte për këtë gjë institucionet e policisë.

Pjesa tjetër ka lidhje me pyetjen tuaj për depozitimin e kërkesës sonë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, pajisjen me fletën tip për të mbledhur 20 mijë firma të qytetarëve. Kjo vjen edhe nga një eksperiencë të mëparshme, jo vetëm e linjës së këshillimit, por edhe e disa organizatave të tjera. Kjo ka qenë mënyra se si ne kemi draftuar ligjin “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet e familjarëve”. Kemi mbledhur 20 mijë firma atëherë, kur draftuam ligjin dhe sot kam idenë që është i vetmi ligj, i cili është draftuar nga shoqëria civile, janë mbledhur 20 mijë firma dhe Parlamenti pastaj e ka miratuar në dhjetor të vitit 2006. Në fakt, duke pasur edhe këtë lloj eksperience, e cila për ne ka qenë jashtëzakonisht shumë e suksesshme, ne absolutisht kemi edhe planin “a” edhe planin “b” dhe kjo kishte lidhje drejtpërsëdrejti me kërkesën që në kemi bërë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, sepse pa diskutim, duke u konsultuar me juristë, me miq dashamirës, ne e dimë shumë mirë se mënyra më e thjeshtë për të draftuar ligjin është duke bërë një kërkesë dhe këtë ta paraqesësh në një si kjo seancë që ne po bëjmë sot.

Sigurisht, kjo kërkon jo vetëm dashamirësinë, se nuk do thosha që është vetëm çështje dashamirësie, por mund të jetë ndonjëherë edhe çështje kompromisesh ajo që po ndodh si iniciativë në Ministrinë e Drejtësisë, për ribërjen e të gjithë Kodit Penal. Ne nuk mendojmë që kemi kaq shumë kohë në dispozicion sa të presim që Ministria e Drejtësisë të ribëjë të Gjithë Kodin Penal dhe për këtë arsye kemi punuar drejtpërsëdrejti te seksioni 6, që ka lidhje me krimet seksuale. E gjithë kjo atmosferë dhe ky presion nuk vjen vetëm nga organizata e shoqërisë civile, por ndihet edhe te ju, që jeni anëtarë të Parlamentit të Shqipërisë. Tani publiku kërkon të merren masa, edhe Parlamenti të reagojë në një mënyrë shumë të shpejtë, kështu që për planin “b”, që ne mendojmë, që në qoftë se ne nuk do ta marrim dritën jeshile nga ju, do të kërkonim ndihmën e 20 mijë qytetarëve për t’i sjellë projektligjet përpara jush. Sigurisht që kjo është një gjë shumë e gjatë, kërkon shumë burime njerëzore dhe ne nuk do të donim në mënyrë absolute që të shkonim me planin “b”, por ndërkohë nuk donim as të humbim kohën, kështu që paralelisht, kërkesat janë drejtuar në Kuvendin e Shqipërisë dhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Një pyetje tuajën e humba, sepse më duket që linja e internetit nuk ishte e mirë.

Ndërsa pyetja tjetër ishte për standardizimin e kërkesave dhe unë ju tregova paraprakisht që një grup është krijuar, por ndërkohë unë pres që këtij grupi t'i bashkohen edhe njerëz të tjerë. Kjo gjë nuk është një projekt, nuk ka asnjë lloj financimi, por është i gjithi i ndërtuar mbi baza vullnetare dhe mendoj që gjithë ajo protestë, ai marshim që u krye, tregon në një farë mënyre që qytetarët nuk janë të pandjeshëm ndaj kësaj teme, që absolutisht, është shumë e nxehtë në Shqipëri. Kështu që unë mendoj se ne, edhe grupi i ekspertëve që na është bashkuar, që janë njerëz me shumë reputacion dhe shumë të nderuar në fushën e tyre, u përpoqëm të bënim edhe një mbledhje të eksperiencave me gjyqtarë në një moshë të caktuar, pra me shumë eksperiencë, por edhe me gjyqtarë të rinj të sapoangazhuar në sistemin gjyqësor, në mënyrë që të sillnim sa më shumë këndvështrime për sa u përket propozimeve që ne duam të realizojmë. Pa diskutim, ne e kemi mundësinë që t'i standardizojmë kërkesat, kemi marrë edhe mbështetjen e tyre. Ndërkohë jemi duke punuar edhe me organizata të tjera ndërkombëtare, jemi duke kërkuar mbështetjen e tyre, jemi duke kërkuar ndihmën e OSBE-së, ndihmën e projektit të USAID-it "Drejtësi për të gjithë", në mënyrë që e gjithë kjo të jetë një përpjekje e standardizuar.

Kështu që, mundësinë për t'i standardizuar të gjitha kërkesat tona do e kemi në momentin që ju do të na jepni dritën jeshile.

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Luarasi!

Kolegë, keni pyetje apo komente për çfarë u prezantua?

Fjala për ju, zonja Dhima. Më pas e ka fjalën zonja Gjebrea.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare! Faleminderit koleges Hysi për organizimin e këtij takimi!

Falënderoj përfaqësueset e organizatave, të cilat janë sot prezente në këtë takim për të diskutuar një për një problem shumë të rëndësishëm siç është ai parandalimit të dhunës seksuale!

Në fjalën e saj zonja Luarasi theksoi se bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e GREVIO-s kërkohet nga ana e Kuvendit të Shqipërisë të bëhen disa ndryshime ligjore, të tilla si: ndryshimi në përkufizimin e përdhunimit të grave të rritura mbi bazën e mungesës së pëlqimit të dhënë me vullnetin e lirë dhe të mos kërkojnë prova të përdorimit të forcës ose rezistencës; ndryshim në përkufizimin e përdhunimit që përfshin fëmijët e mitur midis moshës 14-18 vjeç; të miratojë masat e nevojshme për t'u siguruar që çdo kundërvajtje e dhunës seksuale midis bashkëshortëve ose bashkëjetuesve të aplikohet sipas parashikimeve në ligj. Për sa më sipër,

unë kam një pyetje për zonjën Luarasi. A mendoni që me ndryshimet e propozuara nga ana juaj situata e dhunës seksuale do të përmirësohet?

Gjithashtu, zonja Luarasi theksoi se ndryshimet në Kodin Penal nuk janë shoqëruar me plane dhe strategji ndërhyrjeje për të parandaluar sjelljet, si dërgimi i autorëve në terapi rehabilitimi apo mbikëqyrjet e ish - të dënuarve për krime dhe dhunë seksuale. Meqenëse kemi të pranishme dy zëvendësministre, atë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe atë të Brendshme, unë kam një pyetje për të dyja zëvendësministret. A keni ju si ministri një strategji apo programe specifike për dhunën dhe krimet seksuale?

Shumë faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Dhima!

Zonja Luarasi, fjala është për ju.

Iris Luarasi – Ju falënderoj për pyetjen, zonja Dhima!

Të gjitha udhëzimet dhe rekomandimet që ka dhënë GREVIO për Shqipërinë për ne kanë qenë pa diskutim një lloj udhërrëfyese për të kuptuar cilat janë ndryshimet që kërkohen në ligj.

Për pjesën që ka lidhje me kulturën e pëlqimit unë do të jap vetëm një shembull për ta diskutuar në formën më bashkëbiseduese. Në adresën e *facebook*-ut të linjës së këshillimit na erdhi një letër e një vajze, e cila kishte qenë viktimë e dhunës seksuale. Ajo tregonte që pasi kishte pasur një raport absolutisht platonik dhe pa asnjë lloj marrëdhënie seksuale me të dashurin për rreth 10 muaj, ai e kishte ftuar për një kafe, që jo rastësisht ishte poshtë një moteli. Pasi kishin pirë kafën, ai i kishte bërë kërkesën për të pasur një raport me njëri-tjetrin. Kur kishin hyrë në dhomë, atje kishte qenë edhe kushëriri i tij dhe sigurisht mbi të kishte ndodhur një dhunë seksuale nga i dashuri i saj dhe nga kushëriri i tij.

Kur filluam të bashkëbisedonim dhe ta pyesnim pse ajo nuk e kishte raportuar dhunën që i kishte ndodhur, përgjigjja e saj ishte përgjigjja që të japin pa fund vajza dhe gra, të cilave mund t'ju ketë ndodhur kjo histori. Ajo tha: “çfarë mund t'i thosha unë policit, prindërve të mi dhe shoqeve të mia në momentin që kisha shkuar me këmbët e mia në derën e një moteli?” Që në momentin që hyri brenda asaj dhome ajo e kishte kuptuar që ishte një rast i turpëruar, i kishte dhënë fund jetës së saj dhe nuk kishte asnjë lloj shansi për ta denoncuar qelbësiat që i shkaktuan këto traumë, me të cilët ajo jeton sot e kësaj dite.

Po ta mendojmë tamam, në kulturën e shoqërisë shqiptare është kjo lloj kulture: nëse rasti i vajzës do të bëhej publik, siç është bërë edhe rasti i vajzave të tjera, shumica e shoqërisë shqiptare do të dënonin vajzën dhe do të thoshin çfarë donte ajo që shkoi në një dhomë moteli.

Në një farë mënyre duket si një marrëdhënie absolutisht normale kur mendon se mund të kryesh raport seksual me të dashurin tënd, dhe je e lirë ta bësh këtë kur ke arritur moshën, por nga ana tjetër në sytë e opinionit do të ishte një vetëvrasje për vajzën.

Kjo është një nga arsytet pse ne mendojmë që duke e futur këtë pjesë në ligj, kur kjo vajzë të shkojë te oficeri i policisë apo pranë një organizate të shoqërisë civile për të denoncuar, nuk do të ketë më barrën për të treguar se ajo ka pasur rezistencë gjatë kryerjes së raportit seksual apo raporti seksual është kryer me dhunë ndaj saj. Praktika ka treguar që shumica e këtyre grave dhe vajzave në Shqipëri, por edhe në shumë vende të tjera të botës, janë aq të traumatizuara në momentin që ju ndodh dhuna sa jo shumë prej tyre shkojnë me vrap te mjekësia ligjore për të mbledhur të dhëna dhe për të denoncuar rastin. Duhet të kalojë një muaj ose dy muaj që një pjesë e tyre të kalojnë traumën dhe pastaj mbase marrin guximin për ta denoncuar dhunuesin. Me ligjin aktual që ne kemi kjo nuk jepet si mundësi, por në qoftë se ligji aktual do të ndryshojë me kulturën e pëlqimit, pa diskutim që nuk do të ishte më barra e provës nga ana e viktimës, por do të ishte vetëm për t'u kuptuar se çfarë kishte ndodhur në të vërtetë.

Nga ana tjetër ne e dimë shumë mirë që kjo nuk është një ndërhyrje që realizohet vetëm me ndryshime në Kodin Penal, kjo kërkon një ndërhyrje në Kodin Civil dhe në legjislacionin për politikën e punësimit të njerëzve në shkollë. Duhet të kalohen patjetër në një sitë jo vetëm mësuesit, që do të jenë në kontakt me fëmijët, por praktika ka treguar që në të njëjtën sitë duhet të kalojnë edhe sanitaret dhe rojat e shkollave. Edhe ai që hap një byrektorë, që fëmijët në orën e pushimit të blejnë një byrek, duhet të kontrollohet për të kuptuar nëse ka një lloj rreziku për të qenë në kontakt me fëmijët, ndërkohë që ka vetëm një dritare tek oborri i shkollës.

Nga ana tjetër ne e kuptojmë shumë mirë që kjo nuk është një ndërhyrje vetëm për Kodin Penal, por është një ndërhyrje absolutisht shumë më e gjerë sesa kaq. Ne nuk kemi ndjesinë që me këto ndryshime situata në Shqipëri nga e zezë do të bëhet e bardhë, por mendojmë që pak nga pak të gjitha ndryshimet pa diskutim që sjellin një lloj impakti dhe e gjitha ka lidhje edhe me kulturën e parandalimit më shumë sesa me kulturën e dënimit. Kështu që, e gjitha kjo duhet të shkojë paralelisht edhe me pjesën e ndërgjegjësimit të popullatës.

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Luarasi!

Para se t'ia jap fjalën zonjës Gjebrea, zonja Kuko keni diçka për të thënë për pyetjen që ju drejtoi deputetja Dhima?

Romina Kuko – Faleminderit, kryetare!

Përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit zonja Dhima për pyetjen tuaj!

Në fakt, Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit specifikisht ngarkohen, sidomos për rastet e të miturve, nga ligji nr. 37/2017, që është Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit, me detyrën që të miturit të njihen jo vetëm si viktimë, por edhe si autorë.

Duhet të kemi parasysh që po flasim për çështje shumë të koklavitura nganjëherë. Për shembull, vitin e kaluar ne kemi pasur një rast ku vetë autorët ishin të mitur. Kështu që, do të duhet të shikojmë të gjitha dritëhijet e asaj çfarë jemi duke diskutuar sot, sepse po flasim për një çështje tejet sensitive. Ndoshta po thyejmë një tabu dhe unë jam shumë e gëzuar që më në fund ne jemi të gjithë bashkë për ta diskutuar.

Për sa i përket Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit dhe atë çfarë e ngarkon Ministrinë e Brendshme dhe Policinë e Shtetit, në çdo vit bëjmë një plan-veprimi në zbatim të këtij kodi, i cili patjetër kërkon ndryshime strukturore, të cilat kanë ndodhur që me hyrjen në fuqi të këtij kodi duke ristrukturuar sektorin kundër dhunës në familje dhe mbrojtjes së të miturve. Jo më kot i kemi bashkë të dyja këto elemente, sepse në rastin e dhunës në familje 50% e rasteve përfshijnë edhe fëmijët, të cilët janë dëshmitarë apo të afektuar dhe patjetër që mbrojtja e të miturve ka komponentin e vet.

Gjithashtu, janë bërë trajnime të punonjësve të policisë për njohjen e shenjave të para dhe trajtimin e rasteve. Një nga elementet që kemi të rëndësishëm është krijimi i hapësirave të posaçme për intervistimin e të miturve, sepse duhet të kemi parasysh që është çështje delikate, ku përfshihet psikologu dhe oficeri i policisë që interviston një të mitur për të zbuluar një krim seksual.

Meqenëse m'u dha rasti, dua të them që roli i pushtetit vendor është tejet i rëndësishëm në pjesën e parandalimit. Kështu që, unë do të doja që bashkarisht me ato propozime, që ndoshta mund të konkludojmë, të përfshijmë gjithashtu edhe rolin e bashkive për shenjat e paralajmërimit të hershëm, por edhe buxhetimin e shërbimeve që bashkitë japin në rastin konkret. Është e pamundur që kjo çështje t'i jepet vetëm një institucioni për ta trajtuar. Siç vetë Irisi e tha, dy policë nuk mund të bëjnë dot punën e një zinxhiri të tërë të mbrojtjes dhe të monitorimit. Kështu që, mendoj se pushteti vendor ka një rëndësi të veçantë dhe të posaçme lidhur me këtë pjesë.

Gjithashtu, dua t'ju informoj se edhe në zbatim të urdhrin të Kryeministrit për mbrojtjen e të miturve, ne kemi filluar të përgatisim një plan masash afatshkurtra për të cilat patjetër që ky komision i nderuar, por edhe partnerët e shoqërisë civile, do të njoftohen. Gjithashtu, kemi

dhënë komente për ligjin “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe unë mendoj që edhe aty ka elemente që do të duhet të përfshijnë një mbrojtje më të mirë të të miturve.

Një komponent që do të doja ta përmendnim këtu është ai i krimit kibernetik. Sot ne jetojmë në një botë ku kontakti fizik nuk është i domosdoshëm për të rënë pre e një krimi seksual. Po flasim këtu edhe për të miturit. Ne kemi bërë disa fushata ndërgjegjësuese dhe në një pjesë të rasteve viktimat kontaktohen nga predatorët nëpërmjet platformave online. Së bashku me UNICEF-in ne kemi bërë një studim të hollësishëm për platformat që shpërndajnë materiale pornografike me të mitur në Shqipëri dhe mund të them që kemi një informacion për këtë pjesë, që patjetër është i mjaftueshëm për të filluar hetimet. Megjithatë, do të duhet që këtë ne ta adresojmë dhe ta sanksionojmë në mënyrë që të kemi protokolle të mirëfillta, që të mos jetë vetëm policia, por të jenë të gjitha institucionet që kanë hapësirën kibernetike në administrim dhe kontrollin e tyre për këtë element.

Për sa i përket pjesës së definicionit të përdhunimit jam shumë dakord, por ndonjëherë ne e dimë që në çështjet e gjykatave përdoret “pranim”, “konsent”, “ishte me dëshirë”. Do të duhet të kemi parasysh që edhe ata që janë psikolog në profesion e dinë shumë mirë, nganjëherë pranimi mund të vijë si pasojë e një trysnie dhe presioni të vazhdueshëm. Pra, siç është shtrëngimi për marrjen e pasurisë, ashtu do të konsiderohet edhe kjo pjesë. Kështu që, ne do të duhet ta kemi edhe këtë element parasysh.

Këto ishin nga ana ime. Ministria e Brendshme është e predispozuar për të bërë gjithçka dhe për të forcuar sa më shumë masat për këtë çështje që po diskutojmë.

Faleminderit!

Eglantina Gjermani – Shumë faleminderit, zonja Kuko për angazhimin dhe kontributin tuaj! Faleminderit edhe për ngritjen e çështjes së pushtetit vendor dhe sidomos buxhetimit të shërbimeve sociale!

Në datën 15 nënkomisioni i Barazisë Gjimore dhe nënkomisioni i Çështjeve Vendore do të ketë një mbledhje për buxhetimit e shërbimeve sociale dhe konkretisht mekanizmin e referimit të dhunës në 61 bashkitë, ku edhe ju do të jeni e ftuar. Kështu që, besoj se do të kemi mundësi për të adresuar dhe rritur vullnetin politik të bashkive për krijimin dhe bërjen efikas të mekanizmit të referimit të dhunës.

Për sa u përket çështjeve që ju ngritët, vullnetit dhe angazhimit tuaj personal dhe të ministrisë pranë nënkomisionit dhe në tërësi për trajtimin e çështjeve, unë e vlerësoj vazhdimisht.

Besoj se në momentin kur këto nisma të diskutohen në komisionet respektive, padyshim që do të kërkohet mendimi juaj me shkrim, i Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale.

Fjalën e ka zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Faleminderit, Tina!

Faleminderit, Vasilika!

Të nderuara kryetare të nënkomisioneve, zonja zëvendësministre dhe kolegë!

E falënderoj Irisin dhe të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile për sqarimin e detajuar për sa u përket nismave të tyre. Padyshim që janë për t'u vlerësuar dhe, ashtu sikurse e tha edhe Irisi, kur ka situata që janë vërtetë shqetësuese, reagimi do të duhet të jetë edhe më i fortë, pavarësisht se besoj dhe shpresoj që ne do të marrim nisma afatgjata që do të ndihmojnë edhe në parandalimin e rasteve të tilla.

Unë do të doja të jepja komentet e mia në lidhje me tri pikat që Irisi parashtroi.

E para, ka të bëjë me përmirësimin dhe ndryshimin e momenteve të veçanta të Kodit Penal. Unë nuk jam juriste, por do të doja të kishte një bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë dhe të gjendej një zgjidhje (në qoftë se ato janë shumë pranë finalizimit të një drafti do të ishte akoma edhe më mirë), që të mos vazhdojmë me “arnimet” që thuhet, por të kemi një konsolidim të prononcimeve. Në qoftë se është nevoja, puna do të jetë akoma më e gjatë dhe do të ketë shumë më shumë nevojë, mbase mund të bëhet një amendim, që pastaj do të reflektohet edhe në një amendim afatgjatë.

Gjithsesi, koleget e mia të nderuara, zonja Hysi dhe i gjithë Komisioni i Ligjeve padyshim janë në gjendje të japin një përgjigje më të saktë në lidhje me këtë, por e mbështes për sa i përket nevojës që ka për ndryshim të Kodin Penal.

Për sa i përket pjesës së dytë, që ka të bëjë me databazën, mendoj që ne duhet ta bëjmë sa më shpejtë këtë. Policia ka shumë të dhëna dhe mendoj se nuk ka ndonjë vështirësi shumë të madhe, por rregullime ligjore që bëjnë të mundur që ne të mos cenojmë privatësinë e personit. Nga ana tjetër, përpara rrezikshmërisë dhe të gjithë atyre problematikave që sjellin krime të tilla, të prevalojë nevoja për të ndihmuar viktimën dhe për të parandaluar raste të ngjashme. Kështu që, jam në mbështetje edhe të kësaj databaze, që, në fakt, në dijeninë time, ka shumë vite që diskutohet dhe i falënderoj koleget e mia të shoqërisë civile!

Për sa i përket pjesës së tretë, kastrimit kimik, dhe këtu doja të ndalesha pak, mendoj që do të ketë nevojë për një diskutim në tryeza, ku të ketë ekspertë, mjekë, psikologë, përfaqësues të shoqërisë civile, ligjvënës dhe përfaqësues të qeverisë. Nuk është një gjë e lehtë,

Iris. Unë mora me shpejtësi një libër që e kam te shtëpia ime, me titull *The truth about hormones*, sepse flitet shumë për sa i përket kësaj pjese. Seksi nuk duhet parë vetëm si diçka fiziologjike, por ka edhe elemente të tjera. Mendoj që do të na duhet që ta përtypim pak më mirë këtë gjë, por padyshim që është shumë ndihmues fakti që ju përmendët, që ka vende dhe shtete të tjera, të cilat e kanë tashmë të miratuar këtë.

Pra, duhet të thuhet që ka një argumentim të plotë edhe shkencor në lidhje me këtë, sepse pyetja ime është si e vërtetoni ju që ky personi ka këtë ekzagjerim për sa u përket hormoneve dhe në këtë mënyrë reagon te viktima? Pra, ka shumë elemente, të cilat ndoshta mund të duken të thjeshta, por, në fakt, nuk janë të tilla dhe mund të krijojnë keqkuptime.

Pra, jam në mbështetje si princip, por do të sugjeroja që këtë gjë ta bëjmë në mënyrë të matur, në formën e një diskutimi me analiza dhe ekspertë, të cilët janë në gjendje që të japin vërtetë edhe një mendim pak më shkencor në lidhje me këtë. Padyshim unë e kuptoj që e gjitha kjo vjen nga një shqetësim që është më se i natyrshëm. Të gjithë jemi tronditur nga ngjarje të tilla, jemi në mbështetje të viktimave, shpresojmë që raste të tilla të mos ndodhin dhe me të vërtetë me masat që do të marrim do të jemi në avangardë të këtyre gjërave.

Faleminderit dhe suksese!

Faleminderit dhe komplimente të gjithë grupimit të shoqërisë civile në lidhje me këtë!

Eglantina Gjermani – Shumë faleminderit, zonja Gjebrea!

Ka kërkuar fjalën zëvendësministrja e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, zonja Kospiri. Fjala për ju.

Bardhylka Kospiri – Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë prezentë!

Të nderuara përfaqësuese të shoqërisë civile!

Ishte një prezantim shumë i domosdoshëm dhe i nevojshëm në momentin e duhur për shqetësimin që ne kemi të gjithë si shoqëri, por edhe si institucione për problemin e dhunës seksuale te fëmijët dhe tek të rriturit.

Eglantina Gjermani – Zonja Kospiri, ju lutem, flisni më afër mikrofonit që të dëgjoheni, si dhe hapeni kamerën, sepse ne nuk ju shikojmë.

Faleminderit!

Bardhylka Kospiri – Ka luhatje të internetit ...

Eglantina Gjermani – Ne ju dëgjojmë, por jo shumë mirë.

Bardhylka Kospiri – Me sa duket, ka luhatje të internetit, sepse fiket dhe ndizet vetë.

Atëherë, Ministria e Shëndetësisë dhe e Çështjeve Sociale e vlerëson reagimin e përbashkët të një numri shumë të madh organizatash për një çështje kaq të rëndësishme, si

parandalimi dhe lufta kundër dhunës seksuale. Ajo që është më e rëndësishme, që unë e vlerësoj shumë, është fakti që bashkimi i përpjekjeve tuaja si organizata dhe yni si institucione dhe reagimi i përbashkët në mënyrë të koordinuar është vërtet domethënës, për më tepër kur rastet e dhunës i kemi pasur shumë të pranishme kohët e fundit dhe situata është shumë emergjente dhe duhen marrë masat në mënyrë më të shpejtë.

Në përgjigje të pyetjes që bëri zonja Dhima, do të thosha se Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale është në procesin e vlerësimit të përmbushjes së objektivave të strategjisë ekzistuese të barazisë gjinore dhe së shpejti do të fillojmë rishkrimin e strategjisë së re. Kështu, pa dyshim, masat për mbrojtjen ndaj dhunës seksuale do të jenë shumë shpjegues pjesë e strategjisë së re.

Në vijim të çështjes që ngriti edhe zëvendësministrja Kuka për sa i përket bashkëpunimit me pushtetin vendor, pa diskutim që është shumë i rëndësishëm, sepse fenomenet ndodhin në komunitet dhe duhet të jenë të gjithë të përfshirë, si qytetarët, por edhe mekanizmat e ngritur duhet të bëjnë punën e tyre. Unë do të thosha që bashkitë, në bashkëpunim me Agjencinë e Mbrojtjes së Fëmijëve, të cilat bashkëveprojnë me të gjitha strukturat e tjera në nivel vendor, që trajtohen edhe më tej lidhur me rastet e dhunës seksuale, duhet të bashkëveprojnë mirë, sepse është domosdoshme për të bërë të mundur të fillohet me parandalimin më tej me ndjekjen dhe marrjen e masave pas një veprimi të ndodhur lidhur me dhunën seksuale. Ashtu siç e kemi bërë prezente, tashmë kemi qendrën “LILIUM”, e ngritur në vitin 2018, për viktimat e dhunës seksuale. Nga kjo qendër kam një statistikë, ku nga 50 rastet e trajtuara për dhunë seksuale 60% e tyre janë fëmijë dhe 80% e rasteve janë gra dhe vajza minorene. Trajtimi i rasteve është bërë në mënyrë të disiplinuar, duke konsideruar dhe duke i marrë në mbrojtje me terma afatgjatë këto viktima. Megjithatë, kjo është e pamjaftueshme dhe në një plan të afërt kemi kërkuar dhe po planifikojmë të ngremë edhe qendra të tjera për trajtimin e rasteve, por nuk është kjo më kryesorja, por ajo që ka të njëjtin parandalimin. Kështu që unë i gjej shumë me vend edhe propozimet e organizatave të shoqërisë civile si në kërkesën për ndryshimin për ashpërsimin e masave në Kodin Penal, ashtu edhe për veprimet e tjera lidhur me pjesën e statistikave apo edhe me pjesën e masave në kuadrin shëndetësor, meqenëse, sipas OBSH-së, këto konsiderohen sëmundje mendore dhe duhen marrë masa. Gjithashtu, e mbështes atë që tha zonja Gjebrea se duhet të tregohemi të kujdesshëm dhe duhet ta bëjmë objekt të një diskutimi më të gjerë me specialistë me eksperiencë nga vende të ndryshme që të na sjellin eksperiencë të ndryshme dhe jo të gjitha të njëjta. Unë besoj se do të kemi një rezultat më të shpejtë, sepse nuk është vetëm realizimi i

këtij takimi sot, por janë të angazhuar të gjithë aktorët në një proces bashkëveprimi, si shoqëria civile, institucionet, por edhe parlamenti tashmë e kanë në fokus këtë çështje, si dhe shpresoj se do të kemi një situatë të përmirësuar lidhur me këtë problematikë.

Duke përfituar nga rasti, dua të pyes të tria përfaqësueset e organizatave, të cilat kanë sjellë një set të mirë rekomandimesh. Pyetja ime është pak specifike kur flasim për ashpërsimin e masave në Kodin Penal, duke filluar që nga përkufizimi i përdhunimit të grave mbi bazën e mungesës së pëlqimit të dhënë me vullnet të lirë. Unë dua të ndaloj këtu, duke adresuar një kategori pak të veçantë, sepse po flasim për personat me aftësi të kufizuara mendore që janë nga grupi më i madh që shpeshherë bëhen objekt i këtij fenomeni. Pra, kur këta persona abuzohen seksualisht, nuk duhet të flitet më për dhënie pëlqimi apo për vullnet të lirë, por kemi të bëjmë me një kategori që është shumë vulnerabël, të cilët edhe komunikimin, por edhe të kuptuarit e kanë të vështirë. Kështu që mbase këtu duhet të kemi një rekomandim konkret dhe të gjithë do të punojmë që edhe kjo pjesë të shikohet me kujdes, sepse edhe pasojat janë më të veçanta se rastet e tjera.

Faleminderit dhe punë të mbarë së bashku!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Kospiri për informacionin, për angazhimin, por edhe për kontributin tuaj si ministri dhe ju si person!

Faleminderit edhe për pyetjen!

Zonja Luarasi, a do të përgjigjeni tani?

Iris Luarasi – Po, patjetër!

Unë do të doja të ndaloja paraprakisht te komentet që bëri zonja Gjebrea. Pa diskutim, ne jemi absolutisht dakord që duhet të kemi një bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë. Për këtë arsye javën e kaluar unë pata një takim me ministren e Drejtësisë pikërisht për këtë shqetësim, ku i kam kërkuar të bashkëpunojmë lidhur me ribërjen e Kodit Penal, në mënyrë që edhe ne të jemi pjesë e procesit që nga fillimi, sepse, sigurisht, do ta bënte më efektive punën dhe të mos mbetemi vetëm te pjesa e konsultimit me grupet e interesit, pasi më pas do të ishte shumë e vështirë që t'u kthehemi disa gjërave, për të cilat është rënë dakord midis grupeve të juristëve nga pikëpamja e grupeve të interesit. Kështu që, duke e njohur këtë lloj eksperience, kjo ishte një nga kërkesat që i kam bërë ministres së Drejtësisë dhe kam marrë dritën jeshile prej saj për të qenë pjesë e grupit që tani në fillimet e ribërjes së Kodit Penal.

Nga ana tjetër, jua thashë edhe pak më parë që të gjithë ne jemi para një trysnie dhe një presioni shumë të madh nga opinioni publik. Ne nuk e kemi shansin dhe luksin për të pritur të gjithë ribërjen e Kodit Penal, të cilin, në qoftë se do ta bëjmë ashtu siç duhet realisht, do të

kërkojë një kohë relativisht të gjatë, por, edhe sikur të kërkojë një kohë deri në fund të vitit 2020, unë përsëri mendoj se koha nuk pret për t'i bërë të paktën këto lloj ndryshime që në një farë mënyrë priten me shumë shpejtësi nga publiku. Kanë qenë vetëm dy vajza, të cilat ishin të mirinformuara që mbledhën firma në mënyrë vullnetare, pa u pajisur me formularin tim nga KQZ-ja. Në një kohë rekord brenda dy ditëve ato kanë mbledhur rreth 29 mijë firma. Kështu që kjo është një nga arsyet e tjera që po ju jap për të treguar se opinionin publik është jashtëzakonisht shumë i ndjeshëm ndaj kësaj situatë për të pritur ndryshime ligjore. Unë mendoj se të paktën ndryshimet ligjore për sa i përket seksionit VI për krime seksuale është një gjë që duhet shikohet në mënyrë të menjëhershme.

Për sa i përket pjesës së kastrimit kimik dhe si e kuptojmë ne nëse ka një ekzagjerim ose jo të dëshirës seksuale që mund të ketë një i rritur ndaj një fëmije, unë mendoj se përgjigjja ekziston te formulimi që ka dhënë OBSH-ja, e cila e konsideron këtë si një sëmundje psikike. Kjo është një nga arsyet kryesore pse rekomandohet kastrimi kimik, duke e quajtur këtë një sëmundje psikike. Kastrimi kimik, në fakt, shikohet si një nga metodat më avangardë për të bërë këtë lloj terapie hormonale që heq dëshirën seksuale të shkelësit. Domethënë, unë këtë nuk do ta shikoja si një kërkesë të tepërt që ne kemi dhe këtë gjë jua thashë edhe pak më parë.

Ne kemi biseduar edhe me njerëz të thjeshtë në lidhje me pjesën e kastrimit dhe secili prej nesh kur bën ushtrimin nëse e ka këtë lloj mëshire, se po e imagjinoj kastrimin tani sikur të ishte një nga ato format e vjetra të Mesjetës, sinqerisht dhe personalisht ju them se, po t'i ndodhte fëmijës suaj, asnjëri nga ju nuk do të kishte asnjë lloj mëshire për atë njeri që e kryen këtë lloj dhune. Kështu që pyetja shumë e madhe e publikut do të ishte: pse kur vjen fjala për fëmijën tënd nuk do të falje dhe kur vjen fjala për fëmijën tim do të falje? Kështu që mendoj se kjo është një nga përgjigjet më të mira që duhet të ekzistojë dhe kjo ka qenë një nga arsyet pse ne e kemi kërkuar pjesën e kastrimit kimik. Në fakt, nuk është një metodë orientale që vjen nga Mesjeta, sepse fakti që e kanë edhe vendet më të zhvilluara të Europës, mendoj se janë kryer të gjitha kërkimet e nevojshme edhe nga pikëpamja psikologjike, edhe nga pikëpamja mjekësore dhe gjithë ky vlerësim për ta realizuar këtë dhe për ta pasur si një mënyrë ndëshkimi për ata që kryejnë krime seksuale me të miturit, mendoj se është bërë. Nga ana tjetër, absolutisht që kjo nuk do të anashkalojë faktin se nuk do të krijojmë edhe ne këtu patjetër grupe që do të kenë lidhje edhe me mjekë, edhe me psikologë për të kuptuar edhe atë që ndodh në kontekstin shqiptar pa asnjë lloj diskutimi.

Harrova t'i përgjigjem edhe një pyetjeje të zonjës Hysi në fillim, kur fola për 98 personat, të cilët e kanë kryer dënimin e tyre. Në fakt, bëhet fjalë për 98 pedofilë, për ata që

janë dënuar nga gjykata për krimin e marrëdhënies seksuale me të mitur. Kështu që mund ta imagjinoni vetë sa i madh duhet të jetë numri i atyre personave, që janë autorë të krimeve seksuale, të cilët e kanë kryer dënimin e tyre. Numri 98 ka lidhje me ata që në gjuhën tonë i quajmë pedofilë, sepse kanë kryer marrëdhënie seksuale me të mitur nën 14 vjeç.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zonja Luarasi!

A ka ndonjë pyetje apo koment tjetër?

Zonja Hysi po kërkon fjalën.

Vasilika Hysi – Ju kërkoj ndjesë, zonja Eglantina, por mos ndoshta e ka kërkuar fjalën zoti Alban Zeneli, sepse e pashë që ngriti dorën më parë se unë dhe unë dua ta respektoj si përfaqësues i opozitës.

Eglantina Gjermani – Zoti Zeneli, nuk dëgjoheni! Ju lutem, a mund ta hapni mikrofonin!

Këtu IT-ja e ka hapur mikrofonin, por, ju lutem, provojeni edhe ju njëherë.

Zonja Hysi, mund të vazhdoni ju dhe ia kalojmë fjalën zotit Zeneli, pasi të rihyjë në linjë.

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit, kolege Gjermani!

Unë dua ta falënderoj zonjën Kuko për të gjithë angazhimin, por edhe për gatishmërinë për të bashkëpunuar edhe me Kuvendin e Shqipërisë për të adresimin e disa çështjeve.

Unë, zonja Kuko, do të doja të bëja me dije se koleget Gjermani dhe Bushka kanë depozituar në Komisionin e Ligjeve një nismë dhe javën tjetër besoj se do të fillojë shqyrtimi i kësaj nisme për ndryshimet në ligjin “Për parandalimin e dhunës në familje”. Ju keni dhënë disa mendime dhe sugjerime, por në fjalën tuaj ju përmendët se në këtë ligj kanë nevojë të adresohen më mirë edhe rastet e dhunës ndaj fëmijëve. A keni ndonjë sugjerim konkret dhe, nëse po, unë do ta vlerësoja shumë që të paktën në fillimin e javës tjetër të kishit informacion, meqenëse unë jam edhe relatore dhe do të doja që ndërhyrjet në ligj, sikurse me të drejtë e tha kolegja Gjebrea, të mos bëhen parciais, pra arna-arna, por, meqenëse ligji është duke u ndryshuar, të parashikohet edhe ky shqetësim që kanë ngritur organizatat e shoqërisë civile që ju e keni gjetur të drejtë?

Gjithashtu, edhe zonjën Kospiri e falënderoj për të gjithë informacionin që ka dhënë, i cili shpesh neve si ligjvënës na mungon dhe do të vlerësoja shumë bashkëpunimin dhe gatishmërinë që tregoni për të marrë masat përkatëse.

Lidhur me shqetësimin që ngriti zonja Luarasi për ndryshimet në Kodin Penal, unë e kam vetë këtë shqetësim, sepse është fusha dhe e gjithë karriera ime në drejtësinë penale të

fëmijëve, por numri total i neneve që propozohen të ndryshojnë, që unë i kam në tavolinë që nga viti 2018, janë të konsiderueshme, të cilat bashkë me propozimet që sillni ju kapin një shifër diku te 20 nene dhe nuk janë pak. Nga ana tjetër, me të drejtë zonja Kuko ngriti një shqetësim që krimet seksuale dhe krimi kibernetik duhen adresuar. Pra, në qoftë se ne do të arrijmë që të prekim Kodin Penal, dhe unë bie dakord me ju që nuk duhet të presim derisa të bëhet Kodi Penal, duhen bërë këto ndryshime, por duhen adresuar edhe pedofilia, edhe pornografia, edhe krimet seksuale në përputhje me rekomandimet e dy konventave të Këshillit të Europës, por edhe një sërë problematikash që kanë lindur në praktikë dhe unë jam shumë dakord. Në këtë kuadër, unë përsëri këmbëngul se jemi të gatshëm dhe do të ishte mirë që këtu të ishte edhe përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë, e cila ka qenë e ftuar, por ata sot kanë pasur një konferencë ndërkombëtare lidhur me korrupsionin, për t'u ulur dhe për të parë të gjitha nenet e depozituara. Është e vërtetë që presioni i opinionit publik ndaj deputetëve është rritur, sidomos ndaj grave deputete, por, nga ana tjetër, personalisht kam preferuar të hesht dhe të mos reagoj për shkak se formulimet që sillen janë parciais, në vlerësimin tim, dhe nuk përmbushin standardin për t'i përfshirë ashtu siç vijnë në Kodin Penal. Nëse ne do t'i kishim miratuar ndryshimet e propozuara në vitin 2018, sot do të vinim për ta riamenduar Kodin Penal me propozimet që sillni ju. Pra, po t'i shikoni, janë propozime që vijnë në kuadër të qasjeve shumë të grupuara tematike brenda fushës që punojnë organizatat e shoqërisë civile ose një projekti apo një shqetësimi të radhës që del dhe nuk janë gjithëpërfshirëse. Sot mund të mendojmë që të tre komponentët, pra pedofilia, pornografia, dhuna seksuale, si dhe të gjitha rekomandimet janë në tavolinë dhe mund të shikohen.

Unë jam shumë dakord me doktoreshën, zonjën Gjebrea, sepse ne gjithmonë Elonën e shikojmë si deputete, por ajo është një doktoreshë dhe gjenetiste shumë e mirë. Unë do të vlerësoja që të kishim një studim ku ju bazoheni për kastrimin kimik dhe t'ia vëmë në dispozicion të gjithë Komisionit të Ligjeve apo Komisionit të Shëndetësisë që është më i specializuar, meqenëse e keni adresuar edhe të shqetësimet që i keni dërguar Kryetarit të Kuvendit.

E dyta, lidhur me formulimin që ju thoni në Kodin Penal, Kodi Penal nuk ka përkufizime dhe asnjë kod penal nuk ka përkufizime siç është përdhunimi, e të tjera, prandaj duhet t'i shikojmë në tërësinë e tyre të gjitha sugjerimet që sillni.

Për ta përmbyllur, ju kërkoi ndjesë, sepse e mora fjalën dy herë, dua ta përdor këtë seancë dëgjimore, sepse janë njerëz profesionistë, të cilët sinqerisht duan të bëjnë diçka për fëmijët. Ne kemi miratuar një kalendar edhe të grupit të deputetëve "Miqte e fëmijëve" dhe të

gjithë ne këtu jemi anëtarë të këtij grupi pa përjashtim. Ne i kemi kërkuar edhe Agjencisë për Mbrojtjen e Fëmijëve që të na raportojë shumë shpejt brenda korrikut për shumë aspekte që ju i mbuloni në letrën tuaj. Kështu që do të ishte shumë mirë që gjithë këtë informacion ta kishim para se të kalonim në një mbledhje që do të thërrasë Kryetari i Kuvendit, në cilësinë e kryetarit të grupit të deputetëve “Miqte e familjeve”, për t’i adresuar të gjitha këto shqetësime, meqenëse do të ketë seancë dëgjimore ku do të jenë prezente edhe ministrja e Drejtësisë, edhe ministria e Shëndetësisë, edhe Agjencia për Mbrojtjen e Fëmijëve, edhe Ministria e Brendshme, me qëllim që të mos ripërsërisim dhe të merremi me të njëjtat çështje në seanca dëgjimore dhe të mos kemi në fund një produkt. Besoj se, po t’i bashkojmë të gjitha energjitë së bashku dhe me adresimin që do të bëjë Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Nënkomisioni për Buxhetimin dhe shumë aspekte të tjera që lidhen në mënyrë specifike me mekanizmat e referimit të dhunës në nivel vendor, ne do ta zgjidhim këtë problem brenda këtij viti, brenda kësaj legjislature, meqenëse parlamenti vitin tjetër shpërndahet, pasi janë zgjedhjet dhe do të ketë një kompozim tjetër të parlamentit nga zgjedhjet e ardhshme. Gjithsesi, të jeni të bindur që ne si maxhorancë kemi të gjithë vullnetin për t’i adresuar këto problematika dhe e vetmja gjë tashmë është të koordinohemi të gjithë bashkë.

Faleminderit!

Eglantina Gjermeni – Faleminderit, zonja Hysi, për angazhimin dhe për kontributin tuaj!

Zoti Zeneli, a jeni në linjë? Nuk është.

A ka dikush tjetër diçka për të thënë, ndonjë koment apo ndonjë sugjerim lidhur me çka u prezantua? Nuk ka.

Atëherë, unë do të doja t’ju falënderoja të gjithëve për të gjithë pjesëmarrjen aktive, për angazhimin dhe për kontributin tuaj!

Pa dyshim, dua të falënderoj zonjën Luarasi dhe të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile që kanë përgatitur një paketë ndërhyrjeje në një kohë, në fakt, rekord, sepse ishte vërtet një reagim shumë i shpejtë ndaj ngjarjeve që ndodhin. Sigurisht, kjo është një paketë që ndërhyr në disa nivele dhe kërkon pa dyshim diskutime në komisione, formulime sipas standardeve të konventave dhe, për merakun tim, edhe sipas kontekstit shqiptar, duke garantuar që vërtet përmirësojmë ligje apo bëjmë ligje të reja, por duhet të garantojmë edhe mekanizma dhe institucione që monitorojmë zbatimin e tyre për të siguruar ligje të mira edhe në praktikë jo vetëm të shkruara.

Unë besoj se nga të gjithë kolegët këtu, edhe nga Nënkomisioni i të Drejtave të Njeriut, edhe nga Nënkomisioni i Barazisë Gjinore, pa dyshim shprehëm të gjithë vullnetin politik dhe angazhimin tonë për ta trajtuar këtë problematikë më shpejtë, me më shumë përgjegjshmëri, me më shumë ndjeshmëri si qytetare, si prindër dhe si politikëbërës. Të gjithë ne që jemi në këtë nënkomision, jemi edhe në komisione respektive, ku do të diskutohet nisma që ju keni sjellë, dhe do të jemi, pa dyshim, në tryezat ku do të diskutohen të tria çështjet që ju mbuloni me propozimin e sjellë.

Mendoj se kjo shërbeu për të dyja palët, që të njiheshim më mirë me nismat, për të bërë pyetjet dhe për të shprehur angazhimin tonë, ndërkohë që do të vazhdojmë të jemi në kontakt për diskutimet që do të bëhen në komisione.

Shprehim edhe një herë angazhimin tonë maksimal për të mbështetur përmirësimet ligjore, sidomos për të forcuar zbatimin e tyre në praktikë, të paktën, ne si parlamentarë.

Ju falënderoj, zonja Luarasi, zëvendësministre Kuko dhe zëvendësministre Kospiri për punën dhe angazhimin tuaj!

Ju falënderoj, zonja Zajmi dhe zonja Kurti, për prezencën tuaj!

Pa dyshim, i falënderoj të gjithë kolegët!

Do t'ia jap fjalën zonjën Hysi, për të vazhduar me Nënkomisionin e të Drejtave të Njeriut.

Jeni të lirë.

Faleminderit dhe mirupafshim!

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Sikurse jeni në dijeni, Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut ka monitoruar disa institucione të ekzekutimit të vendimeve penale në Fushë-Krujë, Burrel dhe Durrës.

Në fakt, është përgatitur një raport më 21 nëntor 2019, por për shkak të tërmetit nuk u arrit të miratohet në nënkomision. Këtë grup monitorimi e ka drejtuar kolegu i nderuar, Xhemal Qefalia. Raportin e keni përpara. Raporti do t'i shkojë Komisionit të Ligjeve. Qëllimi i raportit është që të shikohet se si janë zbatuar në burgje rekomandimet e Komisionit European për parandalimin e torturës, rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe rekomandimet e mekanizmit kombëtar të parandalimit.

Për dijeninë tuaj, i falënderuar të gjithë kolegët që kanë marrë pjesë në këtë monitorim dhe për gjetjet shumë interesante. Ju i keni përpara, por në lidhje me institucionin e Fushë-Krujës, nga 21 rekomandimet e adresuara nga mekanizmi kombëtar, rezulton se janë plotësuar 10 prej tyre, kurse 11 janë në proces zbatimi.

Për sa i përket institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale në Burrel, pjesa më e madhe e rekomandimeve janë marrë në konsideratë, por ka 2-3 rekomandime në proces, të cilat ne nuk e dimë nëse janë zbatuar sot që flasim.

Për sa i përket institucionit të ekzekutimit të veprimeve penale në Durrës, mbeten në proces zbatimi disa nga rekomandimet e adresuara.

Në fund të raportit të hartuar, ju keni një sërë përfundimesh. Nëse ju do të jeni dakord, të nderuar kolegë, unë do të sugjeroja ta depozitojmë në Komisionin e Ligjeve këtë raport dhe t'i kërkojmë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe tri institucioneve që janë monitoruar nga Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut të na japin një informacion se çfarë ka ndodhur nga muaji nëntor deri më sot, kur po miratohet ky raport, me zbatimin e rekomandimeve që nuk kanë qenë të zbatuara ose kanë qenë në proces zbatimi.

Nëse jeni dakord për raportin, ta miratojmë.

Kush është dakord me raportin? Kundër?

Alban, jeni kundër?

Deputeti Zeneli është kundër.

Abstenime? Nuk ka.

Xhemal Qefalia – Zonja Hysi, para se të kalojmë në miratim, ju lutem, nëse mundem, të konsumoj diçka.

Vasilika Hysi – Patjetër, zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – Së pari, zonja kryetare, falënderoj të gjithë kolegët e mi, që asistuan duke monitoruar përkatësisht institucionet respektive të Fushë-Krujës, Burrelit dhe Durrësit, për angazhimin dhe seriozitetin që patën! Njëkohësisht do të doja të falënderoja Drejtorinë e Përgjithshme dhe drejtuesit e institucioneve, të cilët ishin të vëmendshëm dhe sensibil për të qenë të hapur dhe të disponueshëm, duke marrë në konsideratë edhe sugjerimet që adresoi Avokati i Popullit.

Zonja kryetare, duke mos u zgjatur, pasi ndërhyra në momentin e votimit, do të doja që për propozimin tuaj, për kalimin e raportit në Komisionin e Ligjeve, do të ishte shumë mirë të ishte prezente jo vetëm Drejtoria e Burgjeve, por edhe dikasteri përgjegjës, Ministria e Drejtësisë, si organi që monitorin sistemin e burgjeve, për t'u njohur edhe me problematikat që ka konstatuar grupi, por pse jo, për të ndihmuar edhe në mbarëvajtjen e rekomandimeve që ne kemi shtruar.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit për rekomandimet, zoti Qefalia!

Në fakt, i gjej shumë me vend. Ka një sërë rekomandimesh në raport edhe për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe për Nënkomisionin e Qeverisjes Vendore. Njëkohësisht, raporti mund t'i vihet në dispozicion edhe Këshillit të Ministrave, por, për shkak të kohës që ka kaluar, do të ishte mirë të bënit një shkresë në emër të nënkomisionit, në emrin tuaj, që t'ia përcjellim tri institucioneve për të marrë një përgjigje se çfarë është bërë me zbatimin gjatë kësaj kohe dhe më pas të veprojmë.

Unë e vlerësoj dhe ju falënderoj juve si drejtues i grupit të monitorimit në të tria institucionet dhe të gjithë kolegët që morën pjesë në këtë monitorim!

Raportet janë shumë interesante. Meqenëse kemi zonjën Bushka dhe zonjën Gjermani, të cilat janë anëtare të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, ku raportojnë shpesh institucionet, mekanizmat monitorues, unë do të thosha se ka një lajm të mirë, që nëpërmjet monitorimit të bërë nga Kuvendi i Shqipërisë dhe nga ky nënkomision, shumë nga rekomandimet e CPP-së janë marrë në konsideratë dhe janë zbatuar në këto tri institucione. Me sa kuptoj, duhet të informojmë. Të dyja koleget e nderuara, që janë zëra të fuqishëm tashmë në kuadër të delegacionit, mund ta paraqesin një gjë të tillë. Ndryshimet që ne bëmë te ligjet e reformës në burgje, pothuajse kanë marrë në konsideratë të gjitha rekomandimet që ka bërë CPP-ja në raportin e fundit të vitit 2019. Në këtë kuadër, ne mund t'i bashkojmë gjetjet e këtij monitorimi dhe përmirësimet ligjore për të pasur një raport shumë të mirë, për ta vënë në dispozicion të delegacionit nga ana e parlamentit shqiptar në Këshillin e Europës, që të kenë argumente dhe ta paraqesin si një model suksesi të Kuvendit të Shqipërisë.

Nuk e di nëse jeni dakord.

Unë do të doja t'ju falënderoja dhe ta mbyllim mbledhjen!

Faleminderit, kolegja Gjermani!

Zonja Zajmi, ju falënderoj për prezencën!

Kërkojmë nga ju të na mbështesni më shumë në këtë proces.

Zajmi – Patjetër.

Për ta mbyllur, do të them vetëm dy fjali!

Së pari, ju falënderoj për ftesën në këtë takim të rëndësishëm!

Ju bashkë me përfaqësuesit e shoqërisë civile thatë gjithçka.

Unë do ta doja të shtoja një element që më shqetëson në propozimet për ndryshimet në Kodin Penal. Duke marr shkas nga sfondi i ngjarjeve të dhunimit të disa të miturave, siç është raportuar në media, si në rastin e Kamzës apo vjet në Kavajë, nuk duhet neglizhuar, siç u tha nga disa përfaqësues të Kuvendit, elementi i përdorimit të internetit në këto krime. Domethënë,

përdorimi i internetit si mjet për të ushtruar presion dhe për të arritur qëllimin e realizimit të dhunës apo të marrëdhënieve seksuale me të mitur.

Për fat, duam apo nuk duam ne, një pjesë e mirë e jetës së adoleshentëve dhe gjithsecilit kalon nëpërmjet këtyre komunikimeve, ndaj nuk duhet harruar elementi i fajësimit apo i kriminalizimit të përdorimit të videove, të regjistrimeve si mjet për nënshtrimin dhe për realizimin, në këtë rast, të dhunës seksuale me të mitur.

Së dyti, mendoj se të dyja këto ngjarje kanë treguar se rrjeti i koordinimit për parandalimin dhe mbrojtjen ndërmjet shkollës, pushtetit vendor, familjes e të tjerë, duhet forcuar, pra duhet rritur komunikimi nga një pikë tek tjetra, sepse çdo njeri, që mund të ngrëjë zërin, shpëton nga një traumë dhe nga një krim i rëndë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Nëse nuk keni gjë tjetër për të shtuar, e mbyllim mbledhjen.

Uroj të bëjmë nisma të mira, pasi i kemi të gjitha kapacitetet.

Ju uroj një mbrëmje të këndshme!

Mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar

**Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili**

Sekretare e komisionit